Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues i prokurimit: ***Valon Jahaj: _____***	***Data e autorizimit të ekspertit:*** **14/06/2022**	***Data e dorëzimit të raportit:*** **24/06/2022**

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.06.2022, **OE "TENZOR I.S.S. L.L.C." - Prishtinë**, ka parashtruar ankesën me nr. **202/22**, kundër njoftimit mbi vendimet e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim dhe njoftimit mbi vendimin e AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër **"254-22-3922-1-3-6"** dhe me titull **"Furnizim me paisje për sistemin e kamerave"** iniciuar nga **(AK)** – **AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR - ASHNA.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **kuotimit të çmimit**, vlerë të **vogël**, lloji i kontratës: **furnizim,** vlera e parashikuar e kontratës: **8,000.00 €.**

Datat për fazat e ndryshme të Aktivitetit të Prokurimit deri tek ankesat në OSHP janë si në vijim:

Data e publikimit të njoftimit për kontratë: 05.05.2022
Afati i fundit për dorëzim të ofertave: 13.05.2022
Njoftim mbi vendimin e AK-së: 01.06.2022
Kërkesa për rishqyrtim: 06.06.2022
Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: 10.06.2022
Ankesa në OSHP: 12.06.2022

Konform nenit 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të LPP-së, eksperti shqyrtues i prokurimit i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. DISPOZITAT E SHKELURA NGA AK DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:
Neni 1 – Qëllimi
Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi
Neni 51 - Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Deklaratë e detajuar mbi faktet dhe argumentet

Pas kërkesës tonë për qasje në dokumentacionin e OE fitues, InterAdria L.L.C. kemi vënë re që operatori ekonomik ka paraqitur ofertë teknike me pajisje të prodhuesit kinez Dahua Technology Company.

Brendet Dahua, Hik Vision, Hytera, Huawei dhe ZTE janë të sanksionuara dhe janë në listë të zezë të Shteteve të Bashkuara të Amerikes sipas vendimit të Komisionit Federal të Komunikimeve dhe sipas Ligjit/Aktit për Komunikime të Sigurta i miratuar nga Senati dhe Kongresi Amerikan me 11.11.2021 dhe i nënshkruar nga Presidenti Joseph R. Biden ***<u>për shkak të përgjimeve të paautorizuara që kryhen nga pajisjet e këtyre brendeve nga Qeveria Popullore e Kinës.</u>***

Po ashtu, sipas vendimit Nr.07/66 të datës 23.02.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, sanksionet e Shteteve të Bashkuara të Amerikes janë automatikisht të zbatueshme edhe në Kosovë dhe rrjedhimisht produktet e brendeve Dahua, HikVision, Hytera, ZTE dhe Huawei janë të ndaluara për përdorim në institucionet e Republikës së Kosovës.

Autoritetit Kontraktues i kemi rekomanduar që për faktet e prezantuara te konsultohen institucionet vendore relevante për konfirmim siç janë Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (ASHI), Zyra e Kryeministrit, etj.

Për më shumë, në procedura të tjera tenderuese për kamera dhe sisteme të vëzhgimit në institucionet e Republikës së Kosovës, në raste të njejta është eliminuar OE i cili ka prezantuar sisteme të brendeve të lartpërmendura. Në dokumentacion kemi bashkëngjitur rastin identik ku autoritet kontraktues ka qenë Kuvendi i Komunës së Prishtines ku pas konsultimit me autoritetet vendore të lartpërmendura, kanë marrë rekomandim që OE të cilët prezantojnë produkte të brendeve të lartpërmendura, të eliminohen dhe të vazhdohet me tenderuesin tjetër të përgjegjshëm. Një kopje e këtij vendimi është e bashkëngjitur me ankesë.

AK nuk ka konsultuar institucionet relevante vendore për interpretim profesional ose të paktën nuk është thirrur në ndonjë të tillë në përgjigjen ndaj kërkesës tonë për rishqyrtim. AK në përgjigjen negative të tyre ndaj Kërkesës tonë për Rishqyrtim thirret vetëm në Nenin 59, paragrafin 4 të LPP-së që definon proceset e Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit të Tenderëve.

Rrjedhimisht, AK është në shkelje të:

Neni 1 – Qëllimi përshkak që ka dështuar në sigurimin e mënyres më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi për shkak të mos-respektimit të vendimit të qeverisë ka rezultuar në një rezultat diskriminues për kompaninë tonë dhe kompanitë tjera pjesëmarrëse në aktivitetin e prokurimit.

Neni 51 – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes dhe Neni 70 – Standardet për Sigurimin e Cilësisë përshkak që ka dështuar të kërkon dëshmi të cilat vërtetojnë që pajisjet e ofruara nuk janë të ndaluara për shitje dhe/ose janë të sigurta për përdorim në objekte të rëndësisë së veçantë siç është Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve përshkak që gjatë ekzaminimit ka dështuar të siguron informata shtesë në lidhje me vërtetësinë e ndalesës ndaj brendit Dahua Technology Company.

Neni 69 – Përshtatshmëria Profesionale sepse ka deshtuar të kërkojë dëshmi për Masat e Sigurimit të Cilësisë të pajisjeve të kërkuara dhe/ose të Operatorit Ekonomik.

Vendimin Nr.07/66 të datës 23.02.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për mospërdorim të produkteve të brendit Dahua Technology Company sipas sanksioneve të Komisionit Federal të Komunikimeve.

Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për qasjen në të dhënat personale të transmetuara dhe të ruajtura përshkak të përpunimit të paautorizuar të të dhënave nga brendi Dahua Technology Company.

Ligjit Nr. 06/L-014 për Infrastrukturen Kritike përshkak që ka dështuar që ta ruaj dhe mbrojë infrastrukturen kritike kombëtare (ku bën pjesë edhe ASHNA dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës) dhe ta minimizoj dëmin potencial për infrastrukturën kritike, pasurinë e përgjithshme, humbjet ekonomike dhe sociale, siguruar stabilitetin e qeverisë dhe rritjes së qëndrueshmërinë sipas direktives të Këshillit të BE-së 2008/114/EC të datës 8 dhjetor 2008 dhe përshkak që ka dështuar në respektimin e Nenit 16 që thotë:
Qeveria e Republikës së Kosovës do të sigurojë se informacioni i ndjeshëm rreth mbrojtjes së infrastrukturës kritike evropiane, i dorëzuar në Komision Evropian apo shteteve evropiane, nuk do të përdoret për asnjë qëllim tjetër përveç mbrojtjes së infrastrukturës kritike.

Nëse lexohet raporti i Komisionit Federal të Komunikimeve që është i aplikueshëm edhe në Republiken e Kosovës, shihet qartazi që përdorimi i brendit Dahua Technology Company në infrastrukturë kritike kombëtare ndalohet mu përshkak rreziqeve të papranueshme të sigurisë kombëtare dhe rreziqeve që i kanosen infrastruktures kritike, konkretisht:

1. Ridrejtimit të trafikut të rrjetit ose të dhënave ose ofrimit të qasjes që këto pajisje (në këtë rast Dahua Technology Company) ose shërbime transmetojnë.
2. Shkaktimi i pengesave apo ndërprerjeve të qellimshme të shërbimit nga rrjeti i ofruesit (në këtë rast Dahua Technology Company).

Të gjitha dokumentacionet relevante të apostrofuara përgjatë ankesës janë të bashkëngjitura.

Kërkojmë që në bazë të dëshmive të ofruara, të aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe të eliminohet OE InterAdria L.L.C. ndërsa OE të obligohet të vazhdon me operatorin e përgjegjshëm të radhës.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET ANKIMORE

Fakti 1: Pjesë nga NJK dhe FDT, tek përshtatshmëria profesionale dhe kapaciteti teknik dhe profesional:

4. Ofertuesi duhet te siguroje qe paisjet te jene origjinale dhe te dokumentuara nga prodhuesi per origjinalitetin e tyre	**4.Ofertuesi duhet te dorezoje formularin e autorizimit te nje prodhesi (MAF)apo Autorizim nga perfaqesuesi I prodhimeve ne Kosove (DAF), qe deklaron se ata jane te autorizuar per te shitur, instaluar, mirembajtur dhe per te kryer sherbimet e paisjeve per specifikat e kerkuara me lart.**
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Per pozicionin 1-Furnizim me Turret ip kamerë statike te brëndshme kerkohet garancion 2 vite minimum	**1.Deklarat me shkrim e nenshkruar dhe vulosur.**
2.Per pozicionin 2-Furnizim me Bullet ip kamer statike te jashtme kerkohet garancion 2 vite minimum	**2.1.Deklarat me shkrim e nenshkruar dhe vulosur**

B05 Njoftimi per Kontrate PKQ 3 / 5

3.Per pozicionin 5-Furnizim me HDD External 4TB kerkohet 1 vit garancion minimum	**3.1.Deklarat me shkrim e nenshkruar dhe vulosur**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Raporti i komisionit vlerësues është përgatitur me datën 19.05.2022.

Sipas procesverbalit të hapjes së tenderëve që mbanë datën 13.05.2022, për këtë aktivitet të prokurimit publik janë pranuar në total pesë (5) oferta, si në tabelën në vijim:

Nr.	Tenderuesi	Vlera me TVSH euro
1.	"FATI NET SH.P.K." - Komoran	4,516.18
2.	"KS BESA SECURITY SH.P.K." - Prishtinë	4,909.92
3.	"TENZOR I.S.S" - Prishtinë	3,919.73
4.	"E COONECT AL SH.P.K." - Prishtinë	4,202.06
5.	"INTERADRIA L.L.C." - Prishtinë	3,490.12

Anëtarët e komisionit vlerësues të tenderit kanë qenë:

1. Azem Mecinaj

2. Valon Mustafaj
3. Ardit Bibaj.

Komisioni i vlerësimit të tenderit, nga ofertat e dorëzuar, të gjitha i ka konsideruar si administrativisht dhe teknikisht të përgjegjshme dhe në përputhje me kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, gjithashtu të përgjegjshme sa i përket pershtatshmerisë profesionale si dhe në aspektin ekonomiko-financiar.

Komisioni vlerësues i AK, ka propozuar për tu shpërblyer me kontratë **OE "INTERADRIA L.L.C"** me çmim total **3,490.12 euro**.

Arsyetimi për refuzimin e ofertave te OE tjerë, sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së dhe komisionit vlerësues të ofertave është që ofertat e tyre nuk ka qenë ofertat e përgjegjshme me çmimin me të ultë:

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj *[nuk qe tenderi me çmimin më të ulët]* në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë **"InterAdria L.L.C.,"** për një shumë prej **3490,12** *Euro.*

Vlerësimi i komisionit është aprovuar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit të AK-së me datë 30.05.2022 dhe me datën 01.06.2022, AK e ka publikuar njoftimin mbi vendimin e tyre.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTIN

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË ANKESAVE

Përshkrim i përgjithshëm i aktivitetit të prokurimit

Autoriteti Kontraktues, me anë të këtij aktiviteti të prokurimit publik ka synuar të nënshkruajë një kontratë kornizë me një Operator Ekonomik për furnizim me sistem te kamerave të brendshme, gjithsejtë 18 copë dhe kamera të jashtme 20 copë, si dhe me pajisje përcjellëse të tyre, ka kërkuar edhe një HARD Disk me kapacitet prej 4TB.

Për këtë aktivitet të prokurimit, AK ka përpiluar dosjen e tenderit së bashku me specifika teknike, të cilat janë gjithë përfshirëse, jo përjashtuese dhe jo diskriminuese për OE potencial konkurrent me eksperiencë në kryerjen e furnizimeve të tilla.

OE ankues në Ankesën me numër **P.SH. 202/22**, pretendon së gjatë udhëheqjes se këtij aktiviteti të prokurimit publik AK ka vepruar në kundërshtim me këto nene të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës:

Neni 1 – Qëllimi
Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi
Neni 51 - Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Eksperti shqyrtues i prokurimit në pajtim me autorizimet e mundësuara për të nga ana e LPP-së, konkretisht nenin 114 te Ligjit 04/L-042 i plotësuar, ndryshuar, i ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore te OE ankues dhe për të njëjtat i ka këto të gjetura dhe konstatime:

Pretendimet ankimore të OE ankues:
Pas kërkesës tonë për qasje në dokumentacionin e OE fitues, InterAdria L.L.C. kemi vënë re që operatori ekonomik ka paraqitur ofertë teknike me pajisje të prodhuesit kinez Dahua Technology Company.

Brendet Dahua, Hik Vision, Hytera, Huawei dhe ZTE janë të sanksionuara dhe janë në listë të zezë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës sipas vendimit të Komisionit Federal të Komunikimeve dhe sipas Ligjit/Aktit për Komunikime të Sigurta i miratuar nga Senati dhe Kongresi Amerikan me 11.11.2021 dhe i nënshkruar nga Presidenti Joseph R. Biden ***<u>për shkak të përgjimeve të paautorizuara që kryhen nga pajisjet e këtyre brendeve nga Qeveria Popullore e Kinës.</u>***

Po ashtu, sipas vendimit Nr.07/66 të datës 23.02.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, sanksionet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë automatikisht të zbatueshme edhe në Kosovë dhe rrjedhimisht produktet e brendeve Dahua, HikVision, Hytera, ZTE dhe Huawei janë të ndaluara për përdorim në institucionet e Republikës së Kosovës...

... Për më shumë, në procedura të tjera tenderuese për kamera dhe sisteme të vëzhgimit në institucionet e Republikës së Kosovës, në raste të njejta është eliminuar OE i cili ka prezantuar sisteme të brendeve të lartpërmendura. Në dokumentacion kemi bashkëngjitur rastin identik ku autoritet kontraktues ka qenë Kuvendi i Komunës së Prishtines ku pas konsultimit me autoritetet vendore të lartpërmendura, kanë marrë rekomandim që OE të cilët prezantojnë produkte të brendeve të lartpërmendura, të eliminohen dhe të vazhdohet me tenderuesin tjetër të përgjegjshëm. Një kopje e këtij vendimi është e bashkëngjitur me ankesë...

Përgjigje në Pretendimet ankimore

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të DT, specifikacionit teknik, njoftimit për kontratë, kontrollimit të ofertave të OE të propozuar për tu shpërblyer me kontratë ka konstatuar se OE i propozuar ka ofertuar me produkte të brendit Kinez "Dahua Technology".
Gjithashtu eksperti shqyrtues i prokurimit e ka kontrolluar edhe dokumentacionin e bashkangjitur nga ana e OE ankues, si fakte ndaj pretendimeve të tij ankimore, është pikërisht Vendimi i AK-së KK Prishtinë, për aprovimin e bazuar të kërkesës për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit si në foton e mëposhtme:

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 02.06.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtines, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **29.05.2022** të parashtruar nga **OE "Fati net" SHPK, - Drenas,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi dhe instalimi i kamerave ne objektet e Komunës",** me Nr. të Prok: **616-22-1858-1-2-1 dhe numër te brendshëm 616 22 016 121** nxjerr:

VENDIM

Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e **OE "Fati net" SHPK, - Drenas**, të dt. 29.05.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi dhe instalimi i kamerave ne objektet e Komunës",** me Nr. të Prok: : **616-22-1858-1-2-1 dhe numër te brendshëm 616 22 016 121**, kundër *Njoftimit mbi Vendimin e AK kontrote* te AK –së, të datës 25/05/2022.

1. Vërtetohet *kërkesa për rishqyrtim* e datës 29/05/2022, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit kontraktues.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *ta kthesj ne rivleresim aktivitetin e prokurimit per* **Furnizimi dhe instalimi i kamerave ne objektet e Komunës",** me Nr. të Prok: : **616-22-1858-1-2-1 dhe numër te brendshëm 616 22 016 121 sipas kërkesës për rishqyrtim te datës 29.05.2022**

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

Arsyetim

OE "Fati net" SHPK, - Drenas me datë 29.05.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi dhe instalimi i kamerave ne objektet e Komunës",** me Nr. të Prok: **616-22-1858-1-2-1 dhe numër te brendshëm 616 22 016 121.**

AK bazuar ne dy vendimet e qeverise se Kosoves dhe informatat e pranuara nga Autoritetet pergjegjese se kamerat Dahua dhe Hik vision jane produkte te futura ne listen e zeze te SHBA-ve dhe se nuk mund te instalohen ne rrjetin qeveritar mori vendim per anulim te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues she se lenda te kthehet ne rivleresim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

Ky vendim për aprovim të bazuar të kërkesës për rishqyrtim i cili ka datën **02.06.2022** dhe te drejtat dhe autorizimet të cilat ia jep LPP ekspertit shqyrtues të prokurimit, me kanë obliguar qe të analizoj në tërësi aktivitetin e prokurimit me numër të prokurimit **616 22 016 121,** ku kam konstatuar qe pas këtij vendimi dhe kthimit të aktivitetit në rivlerësim nga ana e AK-së, ata me datën **06.06.2022** kanë nxjerrë Letrat Standarde dhe Njoftimin mbi Vendimin e ri të AK-së lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, kopjet e të cilit vendim me pjesët e rëndësishme të hijezuara po i paraqes në fotot më poshtë:

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: **Furnizimi dhe instalimi i kamerave ne objektet e Komunës.** Numri i aktivitetit te prokurimit: ***616 22 016 121***

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	FATI NET	21380,20€
2.	INTERADRIA L.L.C.	27571,69
3.	PROFESSIONAL ALARM	28784,00

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

AK-ja ka kërkuar sqarim nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë –Departamenti për Kontrollin e Tregut me Mallra Strategjike për pretendimet e ngritura nga nje OE-ik , për llojet e kamerave gjeja se te njëjtat janë ne listën e zeze Amerikan dhe se janë te ndaluara të kyçën ne rrjetin Qeveritare të Kosovës .

Nga sqarimet e marra nga institucioni i përmendur me lart kemi kuptuar se ky lloj i kamerave nuk është i ndaluar ne tregun Amerikan ,Evropian e as ne tregun e Kosovës ,andaj edhe komisioni i rivlerësimit vendosi qe me kontratë - Furnizimi dhe instalimi i kamerave ne objektet e Komunës, ta shpërblejë OE-ik "PROFESSIONAL ALARM "

Ne vazhdim keni shkresën zyrtare nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Departamenti për Kontrollin e Tregut me Mallra Strategjike.

Të nderuar ,

- DKTMS-ja nuk kontrollon importin apo eksportin e këtyre kamerave deri sa nuk hyjnë në Listën e mallrave me përdorim të dyfishtë apo Listën e mallrave ushtarake, konform klasifikimeve dhe specifikave teknike të përcaktuara me lista , paisjet të cilat hyjnë në këto lista i nënshtrohen procedurave të licencimit . Ne rastin konkret këto kamera nuk i nënshtrohen procedurave të licencimit nga ana e Departamentit..
- Kosova nuk ka ndalesa për këto mallra , nëse referoheni ne vendimin e datës 23.02.2021 lidhur me zbaimin e sanksioneve ekonomike ndërkombëtare ndaj etniteteve dhe personave fizikë që përcaktohen sipas listave të sanksioneve të vendosura nga ; OKB-ja BE-së , dhe SHBA ju sqarojm se ;

SHBA-ja kontrollon EKSPORTET e teknologjisë së ndjeshme, por JO IMPORTET, kështu që kjo teknologji nuk do të mbulohej nga AER nëse do të importohej në SHBA.Ligji amerikan ka të bëjë kryesisht me teknologjinë e ndjeshme që përdoret kundër interesave të sigurisë amerikane. Listimi për Dahua në listën e subjekteve ndalon eksportimin e disa teknologjive të avancuara nga SHBA në Dahua për përdorim në produktet e saj ose për rishitje.(interpretim ky i zyrtareve kompetent nga Ambasada e SHBA-se).Sidoqoftë si Departament së bashku me

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Komisionin ndërministror për kontrollin e tregut dhe licencimin e mallrave strategjike (pjesë e këtij komisioni janë MINT,MPJD,MM,DK,MPB) e kemi trajtuar rastin e këtyre kamerave gjatë muajit dhjetor 2021 dhe janar 2022, Pjesë e takimit dhe komunikimeve kanë qenë edhe zyrtarët e AIP dhe policisë kufitare. Vendimet e Qeverise së Republikës së Kosovës duhet të trajthen me shumë kujdes në rastin e interpretimeve dhe zbatimeve të sanksioneve.Në mungesë të njohurive të mjaftueshme rreth zbatimit të vendimeve rreth sanksioneve jemi adresuar tek partnerët tanë konkretisht Ambasada e SHBA-se në Prishtinë, dhe në momentin e marrjes së opinionit dhe rekomandimeve kemi liruar kamerat të cilat kanë qenë të bllokuara për tu importuara në Kosovë nga Dogana. Keni parasysh se këto kamera në shtetet e BE-se janë të lejuara për tregtim dhe përdorim po ashtu të njëjta shiten edhe në tregun e SHBA-së e madje kemi verifikuar edhe vet në burimet e hapura, përkatësisht në amazon.com, ku gjenden artikuj të brendit Dahua dhe Hikvision dhe shitësi është Amazon apo në një rast tjetër një shitës tjetër me adresë të lokacionit në Washington. Mendoj se rastet e tilla duhet të trajtohen me seriozitet të lartë në mënyrë që mos të ndëshkohen tregtarët që importojnë këto mallra në Kosovë dhe njëkohësisht të sigurohemi dhe të informohemi të gjithës se këto kamera a lejohen të instalohen në Institucione shtetrore dhe kush është Autoritei që e përcakton një gjë të tillë? Gjithnjë bazuar në informacione që kemi mar si komision se shumica e Institucioneve të Kosovës kanë të instaluara kamera të markës HIKVISION , e në rastin konkret edhe MINT ka të instaluara po këto kamerat të markës .

Për me tepër kërkoni sqarime të detajuara nga MPJD pasi ata janë sponzorizues të ligjit 03/L-183 për zbatimin e sanksioneve ndërkombetare .Po ashtu nëse ASHI i ka deklaruar se prodhuesit e këtyre kamerave janë ne listën e zezë të SHBA-ve atëherë shtrohet pyetja se ; zbatimi i këtyre sanksioneve konform vendimeve të QRK a e përcakton ndalimin e importit / tregtisë e këtyre produkteve apo vetëm përdorimin e tyre?

U mundova ta elaboroj këtë temë sepse është trajtuar kohë të gjatën nga ne edhe pse ne nuk jemi autoriteti kompetent por është trajtuar sepse ndalesa e këtyre kamerave në Doganë ka qëndruar për një kohë të gjatë .Për këtë rast mund të informoheni edhe ne Drejtorinë e Doganes.Për cdo informacion shtesë mos hezitoni të na kontaktoni.

Me respekt,
Zana Kotorri
Drejtore e Departamentit për Kontrollin e Tregut me Mallra Strategjike

Departamenti për Kontrollin e Tregut me Mallra Strategjike/Departament for Controlling Market of

KK Prishtina **shpërblen** me kontratën ***OE-ik*** " **PROFESSIONAL ALARM** " me çmimin e poentuar për njësi 2 8784,00€

Data:
Emri dhe mbiemri i UD: Nexhmi Mekolli

Dhe bazuar nga këto sqarime të pranuara nga MINT konkretisht Departamenti Për Kontrollin e Tregut me Mallra Strategjik, AK e KK Prishtinë ka vendosur që përsëri ta shpërblej me kontratë OE fitues të herës së parë, duke u bindur në arsyetimet e organit kompetent.

Andaj bazuar në këto fakte dhe rrjedhimisht nga ky vendim, si dhe përgjigja e Zyrtarëve shtetëror, zyrtarë këta kompetent të lemisë, e arsyetojnë dhe e lehtësojnë në masë të madhe edhe konstatimin e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën për të cilën është përgatitur kjo ekspertizë, qe pretendimet ankimore të OE ankues **të refuzohen si të pabazuara** dhe që për brendet kineze të cekura në ankesë nuk ka ndalesë të përdorimit në territorin e Republikës së Kosovës.

Eksperti shqyrtues konstaton gjithashtu se, AK – ASHNA, me rastin e pranimit të kërkesës për rishqyrtim, me datë 06.06.2022, nuk e ka bërë njoftimin për pezullimin e aktivitetit të prokurimit dhe rrjedhimisht ka bërë shkelje të nenit 12 të LPP-së dhe Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, neni 6 Pezullimi i Aktivitetit të prokurimit.

Përmbyllje e ekspertizës:
Eksperti shqyrtues i prokurimit i propozon Panelit Shqyrtues të OSHP-së, të sjellë vendim për aprovim **si pjesërisht të bazuar të ankesës** duke e lenë në fuqi të Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës **01.06.2022.**

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Duke u bazuar në të gjeturat, krahasimet, faktet, dokumentet e shqyrtuara dhe të cekura në ketë ekspertizë, eksperti shqyrtues i prokurimit, i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE të aprovohet si **pjesërisht e bazuar** dhe që Paneli Shqyrtues i OSHP-së të sjellë vendim për mbetjen në fuqi të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës **01.06.2022**.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - "ASHNA"
- Panelit Shqyrtues - OSHP
- OE ankues - OE "TENZOR I.S.S. L.L.C." - Prishtinë"